



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

---

Nr. 170/16 Prot.

Tiranë, më 21/3 /2013

**Lënda:** Urdhër për Kontrolluesin "Gjykata e Rrethit Gjyqësor" Tiranë.

**U R D H E R**

Nr 11 ,datë 21/3/13

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit "Gjykata e Rrethit Gjyqësor" Tiranë.

**KONSTATOVA**

Në zbatim të urdhrit nr.54 datë 11.03.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "Gjykata e Rrethit Gjyqësor" Tiranë me objekt:

- Verifikimi i ankesës së shtetases A.V drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila lidhet me publikimin e vendimit nr.303 datë 27.05.2011, publikuar në faqen tuaj zyrtare në internet, vendim i cili mbart të dhëna personale të saj.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

Vendimi nr.303 datë 27.05.2011, objekt i verifikimit të këtij inspektimi administrativ, që i përket shtetases A.V., e cila ka bërë ankim më datën 06.03.2013 pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është publikuar në faqen zyrtare në, ashtu siç është në dosjen fizike të çështjes pa marrë masat e duhura për bërjen anonime të të dhënave personale të subjekteve që përfshihen në këtë vendim. Qëllimi i publikimit të këtij vendimi është transparenca dhe informimi publik.

Komisioneri vlerëson se duke bërë publike të dhënat personale të subjekteve të përfshirë në këtë vendim shkelet privatësia e këtyre subjekteve të të dhënave personale, nuk respektohen dhe garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti e drejta e ruajtjes së jetës private, të drejta të cilat janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për

“Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut” si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” duke gene në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” neni 2... “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private”
- Udhëzimin nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”, Kreu IV “ Publikimi i të Dhënave Personale”.

Konstatohet gjithashtu se nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor” Tiranë nuk janë marrë masat e duhura teknike e organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

## URDHEROJ

1. Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dhe Kreut IV të Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”:
  - Të realizohet në mënyrë të menjëhershme, anonimizimi apo inicializimi i të dhënave personale që i përkasin subjektit ankues, A.V., të përfshirë në Vendimin nr.303 datë 27.05.2011, të publikuar në faqen e tuaj zyrtare në internet.
2. Të merren të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor” për të realizuar anonimizimin apo inicializimin e të dhënave personale që i përkasin subjekteve të përfshira në vendimet gjyqësore që publikohen në faqen zyrtare në internet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

